



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:172102

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474144

C.nr.999/20

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm Civil, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Zenel Tasholli, me pjesëmarrjen e bashkëpuntores profesionale Majlinda Xhema Avdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.M., F.M., E.M.,A. M. dhe H.M.. që të gjithë nga fsh.K..K.L...të cilët i përfaqëson i autorizuari Valon Sadiku avokat në Lipjan, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve”E...” me seli në P. , me objekt kontesti shpërblim dëmi, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më datën 08.02.2024, në praninë e të t’autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve M..M., F.. M., E. M.,A.. M.dhe H.M.. që të gjithë nga fsh.K.. K.L., dhe **ILDETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve”E...” me seli ne P..që në emër te kompensimit per shkak te vdekjes se te ndjeres V. M.. nga aksidenti i komunikacionit i dt: 31.10.2020 , sipas përgjegjësisë prej 80% të paditues 20% të të ndjeres V.. M., që paditësve në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e anëtarit të familjes, t’ua paguaj shumat si **në vijim:**

I/a -Për paditësin M.. M.. ne emër te dhimbjeve te pësuar shpirtërore , për humbjen e vajzës, shumen totale prej **10,000.00 euro,**

I/b- Për paditësen F.M.-ne emër te dhimbjeve te pësuar shpirtërore, për humbjen e vajzës, shumen totale prej **10,000.00 euro,**

I/c- Për paditësin E.. M.-ne emër te dhimbjeve te pësuar shpirtërore, për humbjen e motrës, shumen totale prej **6,000.00 euro,**

I/d- Për paditësen A.M.-ne emër te dhimbjeve te pësuar shpirtërore, për humbjen e motres, shumen totale prej **6,000 .00euro**.

I/e- Për paditësen H.M. -ne emër te dhimbjeve te pësuar shpirtërore, për humbjen e motres, shumen totale prej **6,000.00 euro**

II.Për dëmin material:

-për shpenzime të shërimit për të ndjeren V..M..shumën prej.....168.00€

-për shpenzime të varrimit sipas traditave islame shumën prej.....170.00€

-për shpenzime të pritjes së njerëzve për ngushëllime sipas traditave shumën prej 600.00€.

-për shkak të ngritjes së pllakës mbi varr prej.....1,200.00 €.- te gjitha këto me kamatë ligjore prej **8% vjetore**, dhe atë: per demin jo material per shkak te dhimbjeve shpirtërore kamata ligjore rrjedh nga data e marrjes se ketij aktgjykimi 08.02.2024, ndërsa për dëmin material nga dt. e parqitjes së padisë dt.08.12.2020,e te gjitha këto gjerë ne përmbushjen perfundimtare te detyrimit, nen paralajmërimin e përmbarimit te detyrueshem.

Të gjitha shumave të aprovuara duke ja zbritur 20% për shkak të kontributit të të ndjeres V.M..në shkaktimin e aksidentit .

III.OBLIGOHET e paditura qe ne emër te shpenzimeve procedurale, paditësve t’ua paguaje shumen totale prej 6,770.80 euro,te gjitha keto ne afat prej 15 ditesh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nen paralajmërimin e përmbarimit te detyrueshëm.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimi, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi pranë kësaj gjykate me dt.08.12.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit”E...” me seli në P.., me objekt kontesti shpërblim dëmi. Në padi kanë theksuar se me dt.30.10.2020 rreth ores 20:10h në rrugën Shtime Komoran prëkatsisht në rr”Z..J..” kandodhur aksident i komunikacionit me pasja vdekjeprurëse. Pjesëmarrës në këtë aksident komunikacioni ka qenë automjeti V.. G..” me targa 05-... të cilin e ka drejtuar H.S..dhe e ndjera V.. M.. në cilësinë e këmbësore. Deri te aksidenti ka ardhur kur

vetura VW G..e cila ishte duke lëvizur në drejtimin e Sh...-K...me të arritur në udhëkryqin e rr"Z.. J..." –"T..M.." derisa ishte duke lëvizur në shiritin e djathtë në ate moment e ndjera V. M.. ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë për në anen e djathtë dhe me këtë rast automjeti VW G..e godet me pjesën frontale këmbsoren dhe e hedhë në anën e djathtë të rrugës me pasoja me fatalitet.

Me precizimin e lartësisë së kerkespadiisë ka kërkuar nga gjykata që te detyroj të padituren që t'ia shpërblejë dëmin jomaterial dhe material te shkaktuar ne aksidentin e dt.30.10.2020, për shkak të vdekjes së të ndjeres V..M.., për dhimjet shpirtërore për shkak të vdekjes së vajzës për paditësit M. dhe F.M. shumën prej 12.000€ për secilin veç e veç, ndërsa për paditësit E., A..dhe H..M..për humbjen e motrës në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 11.000€ për secilin veç e veç, ndërsa në emër të dëmit material : për shpenzime të shërimit për të ndjeren V..M..shumen prej 168.00€, për shpenzime për varrim sipas traditave islame shumen prej 170.00€ dhe për shpenzime të pritjes së njerëzve për ngushllime sipas traditave shumen prej 600.00€, për shkak te ngritjes së pllakes mbi varr shumen prej 1500€.

Në seancën e dt.08.02.2024 i autorizuari i paditësve ka deklaruar edhe me tutje mbesim ne tërësi pra thenieve të deritanishme, me provat të cilat u administruan konsiderojme që është vërtetuar ne tërësi baza juridike e kërkesëpadiisë. I ka propozuar gjykatës që tia fal besimin ekspertizë se komunikacionit të punuar ne procedure penale për këtë aksident, si dhe ekspertizës se komunikacionit të punuar ne këtë procedure nga eksperti Nol Dedaj, të cilat ekspertiza konstatojme se është shkaktar i vetem dhe ekskluziv për këtë aksident është i siguruari i të paditurës, ndërsa kembesoren nuk e mbajmë pergjegjese për asnje lëshim. Në rast se gjykata vendos që tia fal besimin ekspertizës se komunikacionit të punuar nga eksperti Bajram Latifi dhe ekspertizës se punuar nga grupi i eksperteve të cilat kanë konstatuar që edhe kembesorja ka lëshime sekondare ndërsa shkaktar kryesore i ketij aksidenti është i siguruari i të paditurës, ne varianit me të pafavorshem për ne konsiderojme që kembesorja nuk do të duhej të mbahej pergjegjese me shume se sa 5% për leshimet e saj ne këtë aksident duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe faktoret të cilet kanë ndikuar ne shkaktimin e ketij aksidenti. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj ne tërësi kerkespadiine e precizuar të paditesve, pasi që vetem ne këtë mënyrë dhe ate deri ne një mase të caktuar fare të vogel do të mund të arrihej qellimi i shperblimit të dëmit si dhe satisfaksioni i deshiruar për paditësit të cilet e kanë humbur pergjithmone vajzen respektivisht motren e tyre ne një moshe fare të re.

Shpenzimet e procedures i ka kërkuar dhe ate: për padi 624.00€, për parashtrere për precizim të kërkesëpadiisë 624.00€, për 5 seanca të mbajtura shumen nga 811.20€, për 3 seanca të shtyera pa fajin e pales paditese shumen nga 405.60€ për secilen, për ekspertizë të

komunikacionit 150.00€, gjithsej 6,670.80€, si dhe për taksen gjyqesire aq sa do të vendoset nga gjykata.

I autorizuari i të paditurës në përgjegje në padi e ka kontestuar pjesërisht kërkespadinë e paditësve si të pabazuar si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, me arsyetimin se përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti ka pasur edhe tani e ndjera V. M...

I autorizuari i të paditësve në seancën e dt.08.02.2024, ka deklaruar se Duke mbetur në tërësi pranë deklaramëve të deritanishme në si pale e paditur konsiderojme se tashme është zgjidhur problemi i ndarjes së përgjegjësisë ku me ekspertizë është vërtetuar fakti se përgjegjësi në këtë aksident ka edhe kalimtarja apo tani e ndjera. E kundërshtojmë kërkesën e pales paditëse që gjykata të falë besimin ekspertizës penale dhe ekspertizës të ekspertit N.D.. duke pasur parasysh se ekspertizë penale është nxjerrë në një procedurë ku në nuk kemi qenë palë e në rastin e ekspertizës tjetër eksperti N. D. në seancë ka refuzuar të deklarojë për ndonjë ndarje të përgjegjësisë duke thënë se nuk është i thirrur për atë punë. Andaj i kërkojmë gjykatës që të falë në tërësi besimin e ekspertizës së ekspertit B..L.. si dhe superekspertizës të punuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës H..P..”. Është absurde deklarimi se e ndjera ka vetëm 5% përgjegjësi pasi në të gjitha rastet e deritanishme e në situata të njëjta minimumi i përgjegjësisë së të ndjerës do të ishte 20% pasi shoferi në momentin e aksidentit ka qenë duke vozitur dukshëm nën limitin e shpejtësisë prej 80km/h, dhe e mitura ka bërë tejkalimin e rrugës në mënyrë të pakujdesshme pa ndonjë shenje apo drite dalluese e sidomos duke marrë për bazë moshën e saj pa përcjellje të ndonjë personi të moshës madhore. Andaj i propozojmë gjykatës që ta aprovoj pjesërisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve duke refuzuar shumat teje të larta të cilat janë kërkuar mbi shumat precedente të gjykatave me të larta duke marrë për bazë edhe ndarjen e përgjegjësisë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës të aprovohen duke u vlerësuar sipas suksesit në procedurë dhe duke marrë për bazë prolongimin e panevojshëm të procedurës nga pala paditëse.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, lexoi: Kartoni i QPS L...nr.regjistri 21528, dt. 03.02.2020, Raporti policor i dt. 30.10.2020, nr. 2020-... (me skicë), certifikata e vdekjes me nr.rendor 2774, nr.ref.19/2020RV/19001, dt. 02.12.2020, lëshuar nga ZGJC P..., certifikata e vdekjes me nr. V-... dt. 27.11.2020, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, fletëvdekje me epikrizë me nr. amzës 380/20, dt. 19.11.2020, vërtetimi mjekësor për vdekje nr.362, dt. 19.11.2020, udhëzim i Fakultetit të Mjekësisë me nr.amzës 362/20, dt. 19.11.2020, vërtetim për vdekje dt. 19.11.2020, lëshuar nga Klinika e QKU P..., deklaratë për bashkësinë familjare me nr.rendor 13/13001/2, dt.27.11.2020, certifikata e martesës me nr.rendor 444, dt. 30.11.2020, letërnjoftimi i paditësit M. M... me nr..., letërnjoftimi i paditësës

F. M..me nr. ID...ekstrakt nga regjistri qendror i Gjendjes Civile nr.ser. E ..., dt. 30.11.2020, lëshuar nga ZGJ K..., ekstrakt nga regjistri qendror i Gjendjes Civile nr.ser. E 24792269, dt. 30.11.2020, lëshuar nga ZGJ Kraishtë, ekstrakt nga regjistri qendror i Gjendjes Civile nr.ser. E, dt. 30.11.2020, lëshuar nga ZGJ K., Kërkesa për shperblimin e dëmit material dhe jomaterial 01.12.2020, Parashtrësia për plotësim dokumentacioni nga e paditura përmes e-mail, Parashtrësia për plotësim dokumentacioni dt. 02.12.2020, e dorezuar nga i autorizuari i paditesve të paditurës dhe ate: fatura nr....., dt. 01.12.2020, deftesa nr. ..., dt. 20.11.2020, lëshuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 19.11.2020, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 12.11.2020, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 07.11.2020, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 14.11.2020, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 16.11.2020, receta për barëra me nr.amez 380, dt. 17.11.2020, kuponat fiskal (në tri faqe), fatura nr. 11-..., dt. 01.12.2020, Kuponi nr....., dt. 23.11.2020, Kuponi nr....., dt. 21.11.2020, Kuponi nr..... dt. 22.11.2020, pergjigja ne padi C.nr.999/20, fatura nr. 02/21, e dt. 10.10.2021, lëshuar nga G...M. O.. P., konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit H. I. me nr. PP/II.nr.4594/2020,dt. 03.11.2020, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit B.L. e dt. 23.11.2022, procesverbali C.nr.999/20, dt. 21.12.2022, ne të cilen është bërë adminsitrimi i provës përmes dëgjimit të ekspertit B..L., mendim dhe konstatim i ekspertit të komunikacionit N..D..dt. 26.12.2022, procesverbal C.nr.999/20, dt. 30.01.2023, ne të cilen është bërë nxjerrja e provës përmes dëgjimit të ekspertit Nol Dedaj, parashtrësia për precizimin e kerkespadise C.nr.999/20, dt. 01.02.2023, procesverbali C.nr.999/20, dt. 03.04.2023, ne të cilen është bërë ballafaqimi i eksperteve të komunikacionit B. L..dhe N.D., ekspertiza e grupit të eksperteve nr.prot 0153, dt. 12.12.2023.

Nuk është kontestues fakti qe me datë 31.10.2020 në rrugën Shtim-Komoran përkatish në udhëkryqin e rrugës”Z.. J..-“T..M..” ndodhur aksident komunikacioni.

Nga raporti i Policisë së Kosovës 2020-AR-... i dt.30.10.2020, vërtetohet se me dt.30.10.2020 ka ndodhur aksident komunikacioni nga ngasesi i automjetit VW G... me targa 05-... ,nga drejtuesi i automjetit i cili duke lëvizur në rr”Z.. J..” –T. M.. në anën e djathtë të rruges, në momentin kritik këmbësorja V.. M..kishte kaluar rrugën tërthorazi nga ana e majtë në të djathtë, me ç’rast goditet nga automjeti në lëvizje me pjesen frontale të tij, duke e hedhur në anën e djathtë të rrugës. Këmbësorja është dhënë ndihma e parë në Ambulancën në Shtime, ku pastaj dërgohet në QKUK në P...

Nga certifikata e vdekjes me nr.serik V1.... e dt.19.11.2020 e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se V.M.. ish nga fsh.K..K... ka vdekur me dt.19.11.2020 në P...

Nga çertifikata e vdekjes e dt.27.11.2020e lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë , gjykata vërtetoi se Vlora Metaj ishte nga fsh.Krojmir K.Lipjan ka vdekur si pasojë e aksidentit në trafik.

Nga deklarata e bashkësisë familjare nr. F 11014049 dt.27.11.2020 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Zyra e Gjendjes Civile në L..., gjykata vërtetoi se paditësi M. M. jeton në bashkësi familjare me F.M.. –bashkëshortja dhe fëmijet E., V., A.. dhe Hysnie M.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, në lartësinë e dëmit që kërkohet nga paditësit për dhembjet shpirtërore për shkak të humbjes së të ndjeres V. M. nga aksidenti i pësuar.

Për të përcaktuar bazën e kërkesëpadisë, pra përgjegjësinë për aksidentin e shkaktuar, gjykata ka marrë për bazë, superekspertizën e komunikacionit e dt.12.12.2023 te ekspertve prof.N.L..., mr.sc H. P..dhe msc. E.Q., lidhur me aksidentin e dt.30.10.2020 u vërtetua se shkak i aksidentit janë lëshimet e drejtuesit të automjetit G..me targa 05-... të cilen e drejtonte H. S.. dhe që është shkaktar i aksidentit primar, ndërsa e ndjera V. M.. në cilësinë e këmbësore ka dhënë kontribut sekondar(e cila me kalimin –trupimin e rrugës e ka bërë në mënyrë të pasigurt sipas rregullave të sigurisë në komunikacion.

Ndërsa ekspertizës së ekspertit Dr.sc.N. D.. gjykata nuk ia fali besimin pasi në të njejtën vetëm përshkruhen veprimet e lëvizjes së paditëses këmbësore V.. M..., por nuk ka dhënë ndonjë vlerësim se këmbësorja a ka pasur lëshime në komunikacion dhe a ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit.

Baza ligjore

Gjykata, rrjedhimisht nga gjendja e vërtetuar faktike, erdh në përfundim se duhet vendosur si ne pikën **I dhe II** te dispozitivit te këtij aktgjykimi, bazuar ne arsyet ligjore si ne vijim: me nenin 9 te Ligjit per Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 , përcaktohet “**Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit**”, po ashtu me nenin 918 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve te cekur me larte përcaktohet” **Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër**”, ndersa ne nenin 919, par.1 te ketij ligji percaktohet “**Ngjarja,duke marrë parasysh se për cilën kontraktohet sigurimi (rasti i siguruar) duhet të jetë i ardhshëm, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti ekskluziv i kontraktuesve**”.

Me neni 176 paragrafi 1 të LMD-së “ *I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar*” ndërsa me paragrafin 3 të po këtij neni është paraparë që “ *Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi të dëmtuarit , gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit*” dhe nenin 323 të LPK-së është paraparë se “po qëse vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi në të holla apo sende të zëvendësueshme , por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështërsi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së sirë të saj”.

Dhe pas provave të administruara e në veçanti ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve eksperti të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin e plotë , ku të i njëjtit kanë konstatuar se deri tek aksidenti ka ardhur si pasoj e lëshimeve të bëra nga ana e drejtuesit të automjetit dhe lëshimeve sekondare nga ana e këmbësorës(tani e ndjera V. M..)

Andaj, qartë dhe bindshëm është vërtetuar , se kemi te bëjmë me përgjegjësi të ndare dhe atë në këtë ndarje te kontributit në përqindje prej 80% te drejtuesit te automjetit G., H.S., i siguruar tek e paditura , dhe me 20% nga lëshimet e e të ndjeres V.. M..në cilësinë e këmbësorës Gjykata, lidhur me lartësinë e kompensimit te caktuar si ne piken **II** te dispozitivit, iu referuar dispozitave mbi kompensimin e demit material dhe jo material te percaktuara ne nenin 169 par.1 te Ligjit per Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 ne te cilin thuhet” **Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla**”, ndërsa ne par.3 te ketij neni përcaktohet “*Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme*”, poashtu me nenin 184 par. 1. Të LPK-së parashihet se” **Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore**” ndësa me nenin 2 të po kësaj dispozite parashihet” **Ky shpërblim mund t’u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme**”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Mbi bazen e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, e duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura te LMD-es, e me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia te sipërpërmendura, gjykata erdhi deri tek përfundimi se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, dhe e obligoi te paditurën të ua shpërblej demin për formën e demit jo

material per dhimbje shpirtërore e për shkak te humbjes se anëtarit te familjes , ne kuptim te dispozitive ligjore të nenit 184 nen al. 2 të LMD-ës, e duke i pasur parasysh shkallën e dhimbjeve shpirtërore te përjetuara, kriteret e kompanive të sigurimit në fuqi, si dhe praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë, për njohje të dëmit për këto forma te dëmit, gjykata ua caktoi shumat paditësve M..., F...,E..., A.. dhe H..M..., si ne al.I dhe II te dispozitivit te këtij aktgjykimi.

Gjykata, rrjedhimisht sa i përket te drejtës ne kompensim te demit jomaterial per shkak te dhimbjeve te pësuar shpirtërore paditësve të cilët kanë jetuar në bashkësi familjare me të ndjeren V.M..., prinderit M..dhe F. M..., vllau E., dhe motrat A..dhe H.. M..., duke iu referua nenit 184, par.3 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr.04/L-077, ne te cilin përcaktohet **“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore”**, ndërsa sa i përket lartësisë se kompensimit te demit jo material per dhimbjet e pësuar shpirtërore per paditesit për shkak te vdekjes se te ndjerit duke marre parasysh lidhjet familjare, emocionale, tronditjet psikike qe ka shkaktuar vdekja e te ndjerit tek paditësit, intensitetin, kohëzgjatjen dhe pasojat tjera te demit jo material te manifestuara ne forme te dhimbjeve shpirtërore, iu referua 184, par. 1 dhe 2 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve, ne te cilin përcaktohet **“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore”**poashtu parashihet” **Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”**.

Gjithashtu, gjykata lidhur me demin material dhe jo material si dhe shpenzimet e mjekimit te te ndjeres Vlora Meta gjate kohëzgjatjes se mjekimit nga dt: 30.10.2020 e gjer me dt: 19.11.2020, e ku nga faturat-kuponet fiskale te prezentuara nga i autorizuari i paditesve e kalkuluar nga gjykata u konstatua se shuma totale e shpenzimeve te mjekimit per te ndjeren ka qene shuma prej 168.00 euro(duke zbritur shumen prej 20% në 134.40€), iu referua nenit 177 te Ligjit per Mardhenieve te Detyrimeve ne te cilin ne par.1 percaktohet **“Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t`i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij, ndersa par.2 i këtij nenit parasheh “Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitymin e humbur për shkak të paaftësisë për punë”**, duke marre per baze edhe nenin 918 te cituar, atëherë përgjegjësia per kompensimin e këtyre dëmeve i bie te paditures per shkak se i siguruari si shkaktar i aksidentit ka pase polise te vlefshme sigurimi ne momentin e shkaktimit te aksidentit te e paditura.

Gjykata, po ashtu duke marre per baze shpenzimet e varrimit dhe ngritjes se përmendores, te njëjtat i gjykoj mbi bazën e provave te dokumentuara, ku paditesit dokumentuan shpenzimet e varrimit si shpenzimet e ceremonisë se varrimit (ku ne ate periudhe nuk jane mbuluar nga komuna), shpenzimet vijuese ne ushqim dhe pije te nga e pamja per te ndjeren Vlora Meta sipas traditave tona si dhe shpenzimet e ngritjes se lapidarit(shuma te zbritura prej 20%), e të cilat shpenzime jane te dokumentueshme me faktura, arsyeshme dhe te bazuara, duke marre per baze standardin mesatar te rregullimit te nje varri ne Kosove nga familjaret e tij dhe koston qe shkakton ky rregullim, ashtu qe shumat e gjykuara per gjykatën jane te pranueshme, racionale dhe ne përputhje te plote me kriteret ligjore dhe praktiken gjyqesore per shumat e gjykuara per rastet e tilla, duke pas kujdes qe keto shpenzime perbejne mesataren e shpenzimeve qe qytetaret bëjnë me rastin e varrimit te te afërmit te tyre, duke mos lejuar asnjëherë tejkalimin e kufirit te këtyre shpenzimeve nga e zakonshmja ne te pazakonshmen, apo kapërcimin dhe keqpërdorimin e këtyre shpenzimeve.

Prandaj, gjykata, mbi bazën e te gjitha arsyeve te cekura me larte, gjeti se kompensimi i shumave si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, eshte ne proporcion me intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve shpirtore qe paditesit kane pësuar nga vdekja e te ndjeres, duke marre per baze mungesën e vajzës përkatsisht motrës së tyre të tyre, kompensimi ne formë të satisfaksionit do iu mundësoj nje rehabilitim financiar, e këto shuma sipas vlerësimit të lirë dhe bindjes së gjykatës, sadopak do iu mundoj paditësve nje rehabilitim shpirtëror e te cilat asesi nuk mund te zëvendësojnë humbjen e fëmiut, motrës te paditesve dhe pasojave emocionale qe te te njëjtit ka lenë humbja e te ndjeres.

Lidhur me kamatën e aplikuar, gjykata iu referua nenit 382, par.1 te LMD-se ne te cilin përcaktohet detyrimi i debitorit qe vonon permbushjen e detyrimit ne te holla dhe lartesia e kamatevoneses ku percaktohet **“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”**, ndersa par.2 i ketij nenit percakton **“Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”**, ndërsa rrjedhjen e kësaj kamate e përcaktoi ne dy periudha kohore, duke marre per baze edhe praktiken gjyqesore, ku përcaktohet se per demin jomaterial kamatë vonesa rrjedh nga data e nxjerrjes se aktgjykimit nga gjykata e shkalles se parë, ndersa kamatëvonesa per demin material rrjedh nga koha e ushtrimit te padisë ne rastin konkret, duke iu referuar nenit te cekur me larte.

Lidhur me piken **III** te dispozitivit per shpenzimet e procedures, gjykata aprovoi shpenzimet e paditësve, dhe iu referua nenit 452, par.2 te LPK-se, ku parashihet **“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë**

parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra pale t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”, ashtu qe, vendosi qe paditësve t'ua nje shpenzimet e procedurës ne lartësinë e përcaktuar ne ketë pike, ngase, te njëjtat kane qene te domosdoshme ne vërtetimin e gjendjes faktike dhe vendosjen si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, dhe atë: për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 euro, për precizimin e lartësisë së kerkepadisë shumen prej 624.00euro, në emër të përfaqësimit për 5 seanca të mbajtura $5 \times 811.20\text{€} = 4,056\text{€}$, për 3 senca te shtyera $3 \times 405\text{€} = 1,215\text{€}$, për ekspertizë të komunikacionit shumen prej 150.00€ apo shumën e përgjithëshme prej 6,670.80€, si dhe taksë për padi në shumë prej 100.00 €

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës **IV** te dispozitivit, gjeti se pjesa refuzuese e kërkesëpadisë se paditësve sa i përket demit jo material ne forme te dhimbjeve shpirtërore nuk është ne proporcion me intensitetin, natyrën dhe kohëzgjatjen e demit, praktiken gjyqësore, kriteret ligjore qe i kërkon te përmbushen nga Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu qe, gjykata gjeti se kjo pjese e kërkesëpadisë, mbi bazën e arsyeve te cekura ligjore, duhet refuzuar si e pabazuar dhe e paqëndrueshme.

Andaj, gjykata mbi bazën e këtyre dhe arsyeve te cekura me larte e vërtetimit te gjendjes faktike te arsyetuar me lartë, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan,

Departamenti i Përgjithshëm.

C.nr. 999/20 me datën 08.02.2024

Gj y q t a r i

Zenel Tasholli

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj